



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 745 Akti

Nr. 494 Vendimi
Tiranë, më 23.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Anëtare
Olsi Komici	Relator

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 23.12.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Selami Zalli**, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Selami Zalli, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Selami Zalli, do t’i nënshtrohej procesit nga trupi gjykues

i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Suela Zhegu dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga Komisioni u verifikua se subjekti ka plotësuar dhe depozituar, deklaratën e pasurisë, shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), si dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).

4. Trupi gjykues i shortuar në Komision, me vendimin e datës 29.7.2021, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Po në datën 29.7.2021, subjekti i rivlerësimit, u njoftua nëpërmjet postës elektronike, mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, duke iu dërguar dhe pyetëtori standard, si dhe përbërja e trupit gjykues, për të cilën subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me asnjë nga anëtarët e tij.

6. Në datën 23.9.2021, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, njoftoi Komisionin, duke bashkangjitur një kërkesë, ku kërkon pushimin e procesit të rivlerësimit, pasi statusi i ndihmësit ligjor (mbi bazën e të cilit ka filluar kjo procedurë) aktualisht nuk ekziston për shkaqe objektive që nuk lidhen me këtë proces¹. Ndër të tjera, arsye tjetër mbetet fakti se subjekti nuk është lajmëruar dhe as i është nënshtruar provimit testues të Shkollës së Magjistraturës.

7. Komisioni, me shkresën e datës 23.9.2021², i ka kërkuar Gjykatës së Lartë praktikën e përfundimit të detyrës së ndihmësit ligjor Selami Zalli.

8. Gjykata e Lartë, me shkresat e datave 27.9.2021 dhe 5.10.2021³, ka bashkangjitur:

- i. urdhrin nr. ***, datë 22.7.2009, “Për emërim detyre”, të z. Selami Zalli, me detyrën e ndihmësit ligjor duke filluar në datën 23.7.2009;
- ii. urdhrin nr. ***, datë 28.3.2017, “Për lirim nga detyra”, të z. Selami Zalli, në datën 30.3.2017; si dhe
- iii. kërkesën për heqje dorë të ndihmësit ligjor Selami Zalli, drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë.

9. Komisioni në datën 7.10.2021, me anë të postës elektronike, ka kërkuar nga subjekti që në kuadër të një procesi të rregullt dhe në respektim të drejtës për t’u dëgjuar e fton subjektin që

¹Subjekti ka bashkangjitur vërtetimin nr. *** prot., datë 4.8.2021, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku vërtetohet se z. Selami Zalli është i punësuar pranë këtij institucioni nga data 30.3.2017 dhe në vazhdim.

²Shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2021, e Komisionit.

³Shkresat nr. *** prot., datë 27.9.2021 dhe nr. *** prot., datë 6.10.2021, të Gjykatës së Lartë.

të shprehë vullnetin e tij në seancë dëgjimore, fokusi i së cilës do të ishte përfundimi i procesit të rivlerësimit në zbatim të paragrafëve 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

10. Subjekti i rivlerësimit në datë 21.10.2021, me anë të postës elektronike, njoftoi Komisionin se procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk ka filluar dhe, ndër të tjera, ka argumentuar se nuk është subjekt rivlerësimi në kuptim të ligjit, si dhe nuk mund të keqinterpretohet nga Komisioni si heqje dorë nga procesi apo krijim mundësie për dorëheqje, sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, por Komisioni ka detyrimin të shprehet me vendim për këto kërkesa paraprake pa i hyrë në themel të çështjes.

11. Komisioni, me anë të postës elektronike në datën 3.11.2021, ka njoftuar subjektin, ndër të tjera, se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, ka pasur statusin si subjekt rivlerësimi⁴ dhe, për këtë arsye, Komisioni i referohet praktikës së konsoliduar tashmë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵.

12. Z. Selami Zalli, me anë të postës elektronike, në datën 5.11.2021, ndër të tjera, i ka parashtruar Komisionit se nuk është subjekt i rivlerësimit dhe se e ka humbur statusin në datën 23.3.2017, kur fitoi statusin e nëpunësit civil, nuk është në kushtet e nenit 56 të ligjit 84/2016 dhe Komisioni nuk mund të aplikojë si sanksion pikën 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe kërkon caktimin e një seance publike për shqyrtimin e kërkesës së tij.

13. Komisioni, me anë të postës elektronike, datë 23.11.2021, i ka njoftuar subjektit rezultatet e hetimit.

Në rezultate hetimi, Komisioni i ka parashtruar subjektit situatën faktike, ku subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë në datën 22.7.2009 dhe ka ushtruar këtë funksion deri mars të vitit 2017, ku dhe ka paraqitur kërkesën për lirimin nga detyra nga ky funksion në datën 24.3.2017, pasi është emëruar në një detyrë tjetër. Nga kryetari i gjykatës në datën 28.3.2017 është urdhëruar lirimi nga detyra e ndihmësit ligjor dhe se marrëdhëniet financiare përfundojnë në datën 30.2.2017.

Komisioni vëren se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, datë 8.10.2016, subjekti Selami Zalli ka qenë në detyrën e ndihmësit ligjor, detyrë nga e cila është liruar përfundimisht në datën 30.3.2017. Qenia e tij në këtë detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, e bën subjekt rivlerësimi, *ex officio*, bazuar në 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës.

Gëzimi apo pasja e statusit të subjektit të rivlerësimit për z. Selami Zalli, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, përforcohet nga fakti se ka plotësuar dhe depozituar në datën 25.1.2017, deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së, ka plotësuar dhe depozituar në datën

⁴1. Subjekti ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, për periudhën 2009 – 28.3.2017, kur me urdhrin nr. *** datë 28.3.2017, “Për lirim nga detyra”, është urdhëruar lirimi nga detyra me kërkesën e tij. 2.Me kërkesën e datës 24.3.2017, drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë, subjekti ka kërkuar lirimin tuaj nga detyra e ndihmësit ligjor brenda datës 30.3.2017, për arsye se subjekti ishte shpallur fitues në një pozicion pune në një institucion tjetër. 3. Kërkesa për lirim, pavarësisht se është bërë brenda afatit 3-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, nuk është bërë në mbështetje të nenit 56 të këtij ligji, për arsye se ajo nuk i është drejtuar Presidentit të Republikës dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk mund të procedojë me vendim pushimi sipas përcaktimeve në këtë nen. Kërkesa dhe urdhri për lirimin nga detyra janë bërë dhe kanë prodhuar pasoja juridike pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. 4. Subjekti ka depozituar pranë ILDKPKI-së deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionin përkatës në datën 25.1.2017, formularin e vetdeklarimit në DSIK, si dhe atë profesional pranë ish-KLD-së, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe në përputhje me dispozitat ligjore që parashikon ky ligj. 5. Nga korrespondenca e kryer, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2021, konfirmon se subjekti nuk i është nënshtruar testit të aftësive profesionale të zhvilluar nga kjo shkollë

⁵Vendimi nr. ***, datë 25.7.2019 për subjektin V. B (P).

26.1.2017, deklaratën për kontrollin e figurës pranë DSIK-së, si dhe ka plotësuar dhe depozituar në datën 26.1.2017, formularin e vetëvlerësimit profesional pranë KLD-së, dokumente të administruar nga Komisioni për efekt të procesit të rivlerësimit, *Vetting*.

Komisioni ka njoftuar subjektin për fillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, për të cilin subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi.

Subjekti ka kërkuar nga Komisioni pushimin e procesit të rivlerësimit dhe se objekti për të cilën ka filluar kjo procedurë është e pamundur, duke argumentuar, ndër të tjera se: (a) nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016, pavarësisht se ka plotësuar dhe dorëzuar formularët *Vetting*; (b) statusi i ndihmësit ligjor, mbi bazën e të cilit ka filluar procedura e rivlerësimit, aktualisht nuk ekziston, për shkaqe objektive, pasi është fituar më parë statusi i nëpunësit civil, në procedurë të filluar shumë kohë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 (më 30.4.2015); (c) nuk është lajmëruar dhe nuk i është nënshtruar provimit testues në Shkollën e Magjistraturës; (ç) në mungesë të ekzistencës së subjektit, sipas kriterëve që kërkon ligji dhe të mungesës së objektit, vazhdimi i mëtejshëm i procedurave të çështjes bie ndesh, me frymën e ligjit dhe germën e ligjit të rivlerësimit; (d) fakti që rivlerësimi është i përealizueshëm sipas kriterëve të nenit 42 të ligjit, përbën një fakt më tepër që nuk subjekt rivlerësimi në një detyrë që nuk e ushtron dhe as ka mundësi për ta ushtruar në të ardhmen.

Komisioni e ka ftuar fillimisht subjektin në seancë dëgjimore të shprehë vullnetin e tij, në lidhje me përfundimin e procesit të rivlerësimit, në zbatim të paragrafëve 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti në përgjigje të tij është shprehur se procesi ndaj tij nuk ka filluar, nuk është subjekti i ligjit dhe nuk mund të keqinterpretohet nga Komisioni, si heqje dorë, apo si krijim mundësie për dorëheqje, sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, duke kërkuar nga Komisioni që të shprehet në lidhje me kërkesat e tij paraprake dhe pastaj të procedohet, më tej, me themelin e çështjes

Komisioni i është përgjigjur subjektit se kërkesa e tij për lirim, pavarësisht se është bërë brenda afatit 3-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, nuk është bërë në mbështetje të nenit 56 të këtij ligji, për arsye se nuk i është drejtuar Presidentit të Republikës dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të procedojë me vendim pushimi, sipas përcaktimeve në këtë nen, si dhe ka vlerësuar se z. Selami Zalli ka statusin e subjektit të rivlerësimit në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, i është kërkuar subjektit të shpjegojë dhe sqarojë pozitën e tij juridike të statusit të tij edhe mbi mënyrën e përfundimit të këtij statusi, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe Aneksin e Kushtetutës.

Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, në kërkesën e tij të cilësuar paraprake, të datës 23.9.2021, ka kërkuar pushimin e procesit të rivlerësimit për arsye se: (a) nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016, pavarësisht se ka plotësuar dhe dorëzuar formularët *Vetting*; (b) statusi i ndihmësit ligjor, mbi bazën e të cilit ka filluar procedura e rivlerësimit, aktualisht nuk ekziston, për shkaqe objektive, pra, dhe objekti për të cilin është iniciuar kjo procedurë është i pamundur.

Komisioni ka vlerësuar se kjo kërkesë e z. Selami Zalli, pavarësisht se është paraqitur si kërkesë paraprake, ka të bëjë me përfundimin dhe mënyrën e përfundimit të procesit të rivlerësimit,

pra, është një kërkesë që ka të bëjë me rezultatin përfundimtar të procesit të hetimit administrativ për z. Selami Zalli.

Akti i dorëheqjes së subjektit nga detyra e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi (*ex officio*), në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, që në referim të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenit 58, pika 1/a/b/c të ligjit nr. 84/2016, përfundon nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit.

Për situatën ligjore dhe atë faktike të subjektit Selami Zalli, duket se Komisioni nuk ka më kompetenca ligjore për të vazhduar procesin e rivlerësimit, sepse subjektit të rivlerësimit i mungon cilësia subjektive, e cila është një parakusht për procesin e rivlerësimit, për arsye se subjekti nuk bën më pjesë as në kategorinë e subjekteve që rivlerësohen *ex officio* dhe as të atyre në mënyrë vullnetare, pasi nuk e ka statusin subjektiv, sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 4, e Kushtetutës. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur vullnetin për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit, procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdohet më, pas dorëheqjes nga detyra.

Në momentin që subjekti i rivlerësimit Selami Zalli vendosi me vullnetin e tij të lirë të ndërpresë detyrën e tij funksionale si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, fakt ky që e bënte atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, e vetmja procedurë që mund të ndërmarrë Komisioni ka të bëjë me përfundimin e procesit të rivlerësimit sipas njërës prej mënyrave të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, Kodin e Procedurave Administrative apo edhe në Aneksin e Kushtetutës.

Nisur nga tërësia e fakteve të dala deri në këtë fazë të hetimit, duket se procesi i rivlerësimit për z. Selami Zalli, përfundon/ndërpritet në bazë të paragrafit 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjekti të japë shpjegime lidhur me argumentet e Komisionit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

14. Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, me anë të postës elektronike, datë 1.12.2021, ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues me pretendimin se trupi gjykues i Komisionit ka shfaqur mendim për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

15. Komisioni, me anë të postës elektronike në datën 7.12.2021, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se Komisioni, me vendimin e datës 6.12.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, pasi arsyeja e ngritur nga subjekti nuk përbën shkak për përjashtimin e tij.

16. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, datë 8.12.2021, ka kërkuar nga Komisioni shtyrjen e afatit për dërgimin e prapësimeve të tij.

17. Komisioni, me anë të postës elektronike në datën 10.12.2021, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se i jep një afat të ri kohor për kthimin e përgjigjeve deri në datën 22.12.2021.

18. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike në datën 17.12.2021, i ka kërkuar Komisionit për të vazhduar hetimin e thelluar në të tri komponentët që parashikon ligji.

19. Komisioni, me anë të postës elektronike në datën 20.12.2021, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se e fton atë në seancën dëgjimore, e cila do mbahet në datën 22.12.2021, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve.

20. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike në datën 21.12.2021, ka dërguar parashtrimet e tij dhe njofton Komisionin se për arsye objektive në detyrë është në pamundësi për të marrë pjesë në seancë dhe gjithashtu, e ka të pamundur për të dërguar përfaqësues dhe kërkon që seanca të zhvillohet pa praninë e tij.

Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se i ka argumentuar Komisionit se për shkak të shuarjes natyrshëm të statusit, të pretenduar se është subjekt i rivlerësimit, sipas Kodit të Procedurës Administrative, ka kërkuar pushimin e gjykimit, pasi nuk është subjekt i ligjit. Kjo fazë është kapërcyer nga Komisioni pa u shprehur me vendim, sipas kritereve që përcakton Kodi i Procedurës Administrative dhe konkluzionet tregojnë vetëm një mënyrë zgjidhje që Komisioni e ka deklaruar që në fillim.

Subjekti ka shpjeguar se të dhënat në hetimin administrativ janë të njëanshme dhe jo të plota, pa paraqitur rrethana konkrete dhe pa një analizë objektive në kohë dhe hapësirë.

Formularët (*Vetting*) të plotësuar dhe dorëzuar nga subjekti, tregojnë vullnetin e tij nga mos shmangia e rivlerësimit *Vetting*. Subjekti shpjegon se ndryshimi i profilit të punës nuk ka ndodhur në lidhje me procesin e rivlerësimit, për të cilin ka qenë i hapur, po për shkaqe objektive të detyrueshme, një prej të cilave është lidhja me përfundimin e mandatit të gjyqtarit. Nëse kjo do të lidhej me shmangien nga procesi i rivlerësimit *Vetting*, dorëheqja e tij do të ishte efektive me të njëjtin përfundim, por me favore të ndjeshme ekonomike të tilla si përfitimi i pagesave kalimtare për 3 vjet.

Nga Komisioni është arritur konkluzion i parakohshëm, në lidhje me përfundimet dhe procedurën që duhej të ndiqej nëpërmjet dhënies së “dorëheqjes”, në respekt të nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni ka anashkaluar faktin që subjekti nuk është njoftuar rregullisht si çdo subjekt për testim në Shkollën e Magjistraturës. Fakti i të qenit në një marrëdhënie tjetër pune dhe në pamundësi për të zbatuar këtë kriter ligjor të nenit 56/2 të ligjit nr. 84/2016 është një argument më shumë që nuk është subjekt i rivlerësimit kalimtar.

Subjekti thekson se kërkesa e tij që nuk është subjekt i rivlerësimit, jo vetëm që nuk është trajtuar në rrugë procedurale, por është keq interpretuar si heqje dorë, duke ekspozuar qartë vendimmarrjen që mund të merret nga Komisioni. Subjekti ka humbur statusin e magjistratit edhe formalisht në datën 23.3.2017, kur fitoi statusin e nëpunësit civil. Konkluzionet e hetimit administrative janë kontradiktore dhe paragjyquese.

Komisioni ka zgjedhur për praktikë ligjore, një rast me ndryshime dhe dallime themelore, vendimin nr. ***, datë 25.7.2019, ndërkohë që precedenti më i përafërt mbetet vendimi nr. ***, datë 11.3.2019, i cili është vendim i mbetur në fuqi, ndonëse edhe ky rast në kushte shumë më të disfavourshme me rastin e tij. Kjo vërteton mjaft qartë vullnetin e pavesuar të largimit, si dhe pamundësinë për riintegrim në sistem.

Gjithashtu, subjekti shpjegon se ndodhemi përpara rastit të njëjtë, me vendimin nr. ***, datë 11.3.2019 (në fuqi), edhe për faktin se njëra nga shtyllat e rivlerësimit – aftësitë profesionale – nuk mund të verifikohet dhe funksioni nuk ekziston.

Edhe në komunikimet e mëparshme me Komisionin, edhe në lidhje me nenin 56 të ligjit nr. 84/2016, është arsyetuar gabim nga Komisioni. Dispozita e nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 përfaqëson vetëm një mundësi që ligji ia jep magjistratëve në detyrë, që ata të ndahen nga statusi i tyre nëpërmjet dorëheqjes, në rast se duan të çlirohen nga rivlerësimi.

Komisioni nuk ka argumentuar në mënyrë shteruese natyrën specifike të statusit që subjekti gëzon si subjekt i rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk ka bërë cilësimin e saktë të fakteve e situatës ligjore, duke keqinterpretuar apo lënë të paqartë kohën, mënyrën e ndryshimit të pozicionit të punës, si dhe një vlerësim të ndryshimit progresiv.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se Komisioni nuk mund të vendosë sanksionin e pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, sepse sikurse edhe Komisioni ka konfirmuar që subjekti nuk ka dhënë dhe nuk mund të japë dorëheqjen nga një detyrë brenda sistemit, kur në fakt është që nga data 23.3.2017 jashtë këtij sistemi për shkaqe të tjera. Ky sanksion vlen vetëm për magjistratët që japin dorëheqjen nga detyra.

Në përfundim të parashtrimeve e tij, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procesit të rivlerësimit, pasi nuk është subjekt i ligjit, si dhe nëse Komisioni vlerëson që është subjekt, kërkon çeljen e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

21. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

22. Komisioni vëren se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”⁶, subjekti ka qenë në detyrën e ndihmësit ligjor deri në datën 30.3.2017 dhe qenia në këtë funksion si “ndihmës ligjor”, sipas përcaktimit kushtetues e bën atë subjekt të rivlerësimit *ex officio*, bazuar në paragrafin 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës.

23. Procesi i rivlerësimit për z. Selami Zalli ka filluar menjëherë me:

- a. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë ILDKPKI-së në datën 25.1.2017, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së në datën 26.1.2017, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35; si dhe

⁶Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit u shty për 17 ditë, deri në 19.1.2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në fletoren zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë ka përfunduar në datën 31.1.2017.

c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale KLD-së në datën 26.1.2017, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

24. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit Selami Zalli, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen nga kjo detyrë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016;
- iii. Kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. ***, datë 28.3.2017, ka vendosur lirimin nga detyra të subjektit.

25. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes⁷.

26. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

27. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”*.

28. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi i dërgoi atij rezultatet e hetimit në rrugë elektronike në datë 20.12.2021, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për seancën dëgjimore, e cila do të mbahej në datën 22.12.2021, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve.

29. Subjekti i rivlerësimit ka njoftuar Komisionin, me anë të postës elektronike, datë 21.12.2021, se për arsye objektive nuk mund të paraqitet në seancë dhe as nuk ka mundësi të caktojë mbrojtës dhe kërkon vijimin e seancës në mungesë të tij. Në prapësimet bashkëlidhur, subjekti kërkon që procesi ndaj tij të pushohet ose nëse vendoset të hetohet të vlerësohet në bazë të tri kriterëve të vlerësimit.

⁷Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

30. Në seancën dëgjimore të datës 22.12.2021, subjekti nuk ishte prezent, si dhe nuk kishte caktuar një përfaqësues me prokurë. Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë ashtu siç kishte njoftuar më parë subjekti i rivlerësimit që nuk do të ishte prezent.

31. Lidhur me kërkesën e subjektit për të pushuar procesin e rivlerësimit, Komisioni vlerëson se nuk është e mbështetur në ligj, pasi subjekti deri në datën 30.3.2017, ka qenë në detyrën e ndihmësit ligjor, pra, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit.

32. Komisioni nuk mund të vendosë pushimin e procedurës së rivlerësimit, pasi bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016, dorëheqja e subjektit është dhënë brenda afatit të parashikuar nga ky nen, por jo sipas procedurës përkatëse.

32.1 Trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit⁸, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi, *ex officio*.

32.2 Në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh, që referuar nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c”, të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1, të nenit 179/b, të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

32.3 Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit, *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

32.4 Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, kur shprehet: “Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”

33. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga detyra e ndihmësit ligjor. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

34. Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimmarrje të mëparshme⁹, sipas së cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të

⁸ Vendimi nr. ***, datë 25.7.2019 për subjektin V. B (P).

⁹ Vendimi nr. ***, datë 25.7.2019 për subjektin V. B (P).

rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas nenit G, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës.

35. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Selami Zalli.
2. Ndalimin e emërimit të z. Selami Zalli, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall, në datën 23.12.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj